

THE CONCERT



1ST WORLD FESTIVAL OF DEMOCRACY

SË BASHKU

për një botë që ia vlen të jetohet

This Albanian web flyer is in translation.
If you see mistakes, please join us and give us feedback :-)

<http://facebook.com/TheConcertOrg>

TheConcert.org

IDEA

Ne jemi gjenerata e parë në historinë e njerëzimit që kemi edhe lirinë por edhe mjetet që me dëshirë ta formësojmë dhe krijojmë të ardhmen në këtë planet. Në këtë kërkim, zëri i secilit burrë, grua dhe fëmijë duhet të dëgjohet dhe në mënyrë demokratike të merret parasysh për vendime të mëdha.

THE CONCERT (KONCERTI) është festivali i parë botëror i demokracisë, një ngjarje e drejtpërdrejt muzikore që ndodh në të gjitha kontinentet, dhe që tejkalon të gjithë kufijtë kulturor e gjuhësor, me qëllim që ta trasojë rrugën për një dialog të qëndrueshëm global në mes të gjithë njerëzimit.

THE CONCERT do të thërret dhe do të ngrit vetëdijen se ne jemi ata që e kanë në dorë fuqinë për ta krijuar të ardhmen tonë. E kuptojmë ndryshimin global si një mundësi për t'i bashkuar duart dhe forcat për ta kthyer këtë vizion në një realitet global.

Atëherë kur qytetarët, OJQ-të, korporatat, politika dhe shkenca takohen në kushte shoqërore, zbrazëtitrat e vjetra mund të bashkohen me shkëmbim të përbashkët lokal dhe global.

Pa pasur parasysh vendin ku jetojmë, muzika gjithmonë ka qenë mjet paqësor, kyç për tejkalimin e kufijve kulturor dhe gjeografik. Muzika edhe mban edhe krijon një lidhje të bashkimit dhe ka potencial të shquar që ta tërheq vëmendjen globale në këtë çështje të përbashkët të tërë njerëzimit.

Festivali do të prezantohet nga gjenerata e re:
Fëmijët tanë.

Ata kanë të drejtë për një botë ku ia vlen të jetohet.

FESTIVALI

THE CONCERT, festivali i parë botëror i demokracisë, do të ndodhë në të njëjtën kohë në të gjitha kontinentet për 48 orë, me ç'rast do t'i bashkojë njerëzit e të gjithë kulturave, në ajër të hapur, në stadione, salla të koncertit, teatro dhe kinema. Festivali përmban kontribute nga artistët e të gjitha kulturave dhe do të shfaqë performanca të yjeve ndërkombëtare të zhanreve të ndryshme muzikore.

THE CONCERT do të transmetohet drejtpërdrejt përmes radio stacioneve dhe stacioneve televizive, përmes internetit dhe në hapësira të panumërta publike. Hapësirat qendrore të shikimit do të lidhen me transmetim satelitor.

Duke dërguar video mesazhe, fëmijët, artistët dhe liderë e opinionformues të zgjedhur nga tërë bota do t'i ngritin brengat, problemet dhe dëshirat e tyre. Do t'i adresojnë sfidat globale dhe do ta diskutojnë rivlerësimin e vlerave të sotme. Do të bëjnë thirrje për njerëzit që t'i zgjasin kokat dhe duart e tyre për t'i bashkuar në një komunitet global me përgjegjësi të përbashkët. Do të thërrasin që tërë qytetarët e botës të bashkohen në dialog të barabartë në nivel lokal dhe global.

THE CONCERT fillimisht u dizajnuar si projekt në Kombet e Bashkuara në vitin 2000. Me emrin "The Worldconcert" (Koncerti Botëror), projekti mori shumë komente pozitive nga shumë popuj dhe ambasadorë.

THE CONCERT do të jetë një ngjarje globale vjetore për banorët e botës të të gjitha moshave. Është e rëndësishme të veçantë që të krijohet vazhdimësi, të sigurohemi se nuk e lëmë më kurrë anash nevojën për dialog global për t'i përvetësuar sfidat me të cilat ballafaqohemi dhe për ta jetësuar atë që me dekada i mungon njerëzimit: kombet e bashkuara.



agora globale



THE CONCERT është një ngjarje që shënon fillimin e dialogut mbarëbotëror për të ardhmen e njerëzimit. Në mënyrë që ky qëllim të jetë më i prekshëm, projekt unik i internetit për një ueb infrastrukturë të decentralizuar për pjesëmarrje të qytetarëve dhe demokraci aktive do të lansohet në të njëjtën kohë me Festivalin e Parë Botëror të Demokracisë: echo.

Çka është echo?

echo jep një përmbledhje të shpejtë dhe të qartë për propozimet tjera, argumentet pro/contra dhe informata multimediale në lidhje me çështjet shoqërore, dhe ka për qëllim që pozitën e grupeve të ndryshme sociale ta bëjë sa më të kuptueshme dhe transparente. Përmes lehtësimit, shkëmbimit dhe elaborimit kolektiv të ideve dhe teksteve, echo përmbledh njohuritë dhe mendimet që kalojnë kufijtë e ueb faqeve, komuniteteve e gjuhëve të ndryshme. Në këtë mënyrë, echo lidhë njerëzit me qëllime të njëjta në tërë botën. Ofron mbështetje për krijimin e aksioneve të përbashkëta (projekteve, ngjarjeve) dhe për shfrytëzimin e instrumenteve të drejtpërdrejta të demokracisë (p.sh. Iniciativa e Qytetarëve Evropian, Peticioni Elektronik, Referendume, dhe Carrotmob).

Pasuria e përbashkët e tërë njerëzimit

echo është dizajnuar për të qenë një sistem vetë-organizativ. Funkcionet e tij për diskutime mundësojnë vendimmarrjen përtej rregullave dhe funksioneve të veta. Atëherë kur vetë-administrimi do të jetë i qëndrueshëm, menaxhimi i platformës echo do të kalojë në duart e të gjithë përdoruesve në çdo moment.

Në këtë mënyrë, echo do të shndërrohet në kuasi-pasuri të njerëzimit:

Ju vendosni çfarë ndodhë në echo,
Ju e përcaktoni se si echo funksionin,

Ju jeni echo.

<http://echo.to>